

NJOFTIMI DHE DOKUMENTACIONI PËR PJESËMARRJE NË TENDER

Trashëgimia Kulturore pa Kufij – Shqipëri (CHWB - Albania) fton kompani që janë të licensuara në zbatimin e punimeve restauruese në fushën e trashëgimisë kulturore të dorëzojnë oferta financiare, të vlefshme për punë në një objekt kulti, monumentet i kategorisë së parë për projektin: Ndërhyrje Konservuese në “Manastirin e Ungjillizimit”, në fshatin Vanistër, në Gjirokastrë. Ky projekt financohet nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Fondi i Ambasadoreve për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore, të Sh.B.A dhe Ambasada e Sh.B.A. në Shqipëri, përmes CHWB Albania.

Autoriteti Prokurues:

Emri: Trashëgimia Kulturore pa Kufij – Shqipëri (në vijim CHWB-Albania)

Adresa: Rr. Ismail Qemali, P.34/1 Kt. V, Zyra Nr.22, Tiranë, Shqipëri

E-mail: procurement@chwalbania.org

Objekti i tenderit:

Ndërhyrje Konservuese në “Manastirin e Ungjillizimit”, në Vanistër, në Gjirokastrë (Monument i kategorisë së parë)

Përshkrim i shkurtër:

Projekti në fjalë: Ndërhyrje Konservuese në “Manastirin e Ungjillizimit”, në fshatin Vanistër, në Gjirokastrë, është hartuar nga CHWB Albania dhe miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale përkatësisht në vendimin Nr. 52, lëshuar më datë 25.03.2024.

Vendndodhja e Objektivit: Vanistër, Gjirokastrë.

Afati i punimeve:

Kohëzgjatja:

- : Ndërhyrje Konservuese në “Manastirin e Ungjillizimit”, në fshatin Vanistër, në Gjirokastrë – **4 muaj**

Mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit:

Dokumentat e tenderit mund ti merrni me postë elektronike (email), duke dërguar një email interesimi në: procurement@chwalbania.org

Duke filluar nga data e shpërndarjes së këtij njoftimi, **16/04/2024** deri në datën **22/04/2024**, kompanitë e interesuara mund të dërgojnë një email te procurement@chwalbania.org dhe të marrin dokumentacionin e nevojshëm.

Dokumentacioni do të dërgohet elektronikisht nga ora **10:00 deri në orën 16:00**, mbas shprehjes të interesit, nga e hëna në të premte.

Shënim:

Në fundjavë (e shtunë dhe e dielë) zyrat janë të mbyllura. Marrja e materialeve përmes emailit mund të kryhet vetëm në ditë pune gjatë javës.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertës: Ora 11.00, ditën e hënë, 6 MAJ 2024.

II. Kushtet e përgjithshme të tenderit

Ofertuesit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për tu kualifikuar:

- a) ata duhet të gëzojnë të drejtën për të zhvilluar një aktivitet profesional dhe/ose për t'u regjistruar në regjistrat përkatës tregtarë ose profesionalë;
- b) gjendja e tyre ekonomike dhe financiare duhet të garantojë ekzekutimin e duhur të shërbimeve;
- c) aftësia e tyre teknike e profesionale duhet të garantojë një ekzekutim të përshtatshëm të objektit të tenderit.

Oferta do të refuzohet nëse Kompania e Ofertuesit:

- a) ka falimentuar ose po likuidon aktivitetin, ose ka qene ne status pezullimi te aktivitetit perpara marrjes pjesë në këtë tender, ose ka hyrë në marrëveshje me kreditorët, ose ka pezulluar ose kufizuar aktivitetet e biznesit, ose është në një situatë të ngjashme, të shkaktuar nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve e rregulloreve përkatëse të Shqipërisë ose të shtetit të krijimit;
- b) është dënuar për ndonjë shkelje lidhur me sjelljen e tij profesionale;
- c) është gjykuar fajtor nga një gjykatë kompetente e Shqipërisë për sjellje të gabuar profesionale;
- d) nuk i ka plotësuar detyrimet e tij lidhur me pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose shendetesore, në përputhje me ligjet përkatëse të Shqipërisë;
- e) nuk i ka plotësuar detyrimet e tij lidhur me pagimin e tatimeve, në përputhje me ligjet përkatëse të Shqipërisë;
- f) keqinformon dhe/ose dorëzon dokumenta, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi.

Kompania që do të dorëzojë ofertën duhet që:

- të bazojë planin financiar mbi vlerësimin realist të tregut lidhur me çmimet e shërbimeve dhe materialeve;
- të respektojë zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor;
- të ketë në konsideratë të drejtat e njeriut.
- të respektojë legjislacionin vendas mbi trashëgiminë kulturore; ligjin Nr.27/2018 për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzete, si dhe akte të tjera nënligjore të lidhura me përdorimin e monumenteve.

III. Kushtet e veçanta lidhur me zbatimin e projektit të konservimit

Kompania që do të dorëzojë ofertën duhet që të paraqesë prova që dëshmojnë për aftësinë e kompanisë dhe përbushjen e detyrimeve ligjore, teknike dhe financiare në zbatimin e punimeve të restaurimit. Rrjedhimisht, çdo kompani duhet të dorëzojë dokumentacionin në vijim:

1. Kapaciteti Ligjor, duke përfshirë kërkesat lidhur me regjistrimin në regjistrat profesionalë ose tregtarë:

- Një ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR);
- Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) nuk është në proces falimentimi.
- Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) nuk është në proces për shkelje penale, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit.
- Një dokument që vërteton se kapitalet/asetet e (subjektit tuaj) nuk janë në duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit.
- Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar detyrimet fiskale dhe i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Administrata Tatimore.

Këto dokumenta duhet të jenë lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e dorëzimit të ofertave. Dokumentat duhet të jene origjinale ose fotokopje e noterizuar e njësisë me origjinalin dhe nëse janë në gjuhë të huaj të përkthyer në shqip dhe përkthimi të jetë i noterizuar.

2. Kapaciteti teknik dhe profesional

- Një kopje e noterizuar e licencave N-Z/A/3, Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës të kultit, lëshuar nga Ministria e Kulturës.
- Një portofol të punëve të restaurimit që kompania ka zbatuar në pesë vitet e fundit në nivel kombëtar. Kjo dosje duhet të përmbajë të paktën pesë projekte restaurimi. Dokumenti duhet të përmbajë informacion të nevojshëm që tregon eksperiencën e kompanisë. Projekte të ngjashme do të jenë përparësi. Fotografji të zbatimit të punimeve dhe vizatime janë të rëndësishme për të kuptuar llojin e punimeve të zbatuara.
- Ofertuesi duhet të dorëzojë për projektin në fjalë:
 - a) Propozimin e ndërhyrjeve (mendimin teknik bazuar në dokumentat e tërhequr);
 - b) Propozimin teknik (mënyra si mendohet të zbatohen punimet);
 - c) Analizën e materialeve (mendimin teknik në lidhje me materialet që propozohen të përdoren).
- Ofertuesi duhet të dorëzojë për projektin, planin e veprimit të detajuar për mënyrën e kryerjes së shërbimit të kërkuar.
- Prezantimin e strukturës organizative të kompanisë, numrin dhe ekspertizën e punonjësve (numrin e punonjësve të kualifikuar dhe jo) që kompania ka në lidhje me punët restauruese;
- Dorëzimin e CV-së të personit të kualifikuar (ose personave) që do të jetë përgjegjës, p.sh. Drejtuesi Teknik apo përgjegjësi i zbatimit të projekteve.
- Drejtuesi teknik duhet të jetë inxhinier ndërtimi ose arkitekt me eksperience pune në restaurim prej minimumi 10 vjetësh.
- Të ketë mjeshtra dhe ndihmës mjeshtra të certifikuar për punimet specifike të restaurimit.
- 2 letra reference nga investitorë të tjerë me të cilët kompania ka punuar në punë të ngjashme. Këto letra duhet të datojnë jo më parë se 1 vit nga data e tenderimit.

Dokumentat e mësipërm duhet të jenë lëshuar jo më parë se 6 muaj nga data e dorëzimit të ofertës. Dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të origjinaleve dhe nëse janë në gjuhë të huaj nevojitet një kopje e noterizuar në gjuhën shqipe.

3. Kapaciteti Financiar

- Kopje të bilanceve dhe pasqyrave financiare të 2 viteve të fundit.

4. Sigurimi i ofertës

Që një Ofertues të marrë pjesë në këtë procedurë tenderimi, kërkohet që të paraqesë Sigurimin e Ofertës, shoqëruar me Formularin e Sigurimit të Ofertës, që gjendet në Shtojcën 2.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është e barabartë me 5 (pesë) % e vlerës së ofertës

5. Përlllogaritja e kostos

Ofertuesit duhet të plotësojnë për projektin, Formularin e Çmimit të Ofertës, bashkangjitur si Shtojca 1 e këtij njoftimi, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen, një përshkrim të shkurtër të shërbimeve dhe çmimin e tyre.

Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në monedhën e SHBA (USD), duke përfshirë edhe të gjitha tatimet që zbatohen, duke përfshirë TVSH-në (aty ku është e nevojshme). Çmimi total i ofertës do të kuotohet gjithashtu në monedhën e Sh.B.A. (USD). Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Çmimit të Ofertës, çmimet totale të ofertës të të gjitha shërbimeve.

Gjithashtu, përlllogaritja e kostos totale, duhet bazuar mbi plotësimin e preventivit, relacionin teknik dhe vizatimet e projektit të cilat e shoqërojnë këtë dokument. Preventivi, relacioni teknik dhe vizatimet për projektin mund të merren elektronikisht nëpërmjet një emaili në adresën procurement@chwalbania.org Preventivi i plotësuar për projektin duhet dorëzuar në origjinal (i printuar) si dhe në version elektronik. Për zerat që nuk bazohen në çmime manuali duhet të dorëzohen analizat e çmimeve.

- Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III. Procedura e dorëzimit të ofertës:

Gjuha për hartimin e ofertave: gjuha shqipe.

- Oferta duhet dorëzuar në dy kopje: një kopje origjinale me fletë të lidhura, në format A4, si dhe një kopje në format elektronik (CD) e cila duhet të jetë e njëjtë me kopjen origjinale.
- Të gjitha dokumentet e përgatitura duhet të ndahen në dy zarfe. Zarfë i parë duhet të përmbajë dokumentacionin që përputhet me kriteret ligjore dhe teknike. Mbi këtë zarf duhet të shkruhet “**Oferta Teknike**”. Zarfë i dytë duhet të përmbajë dokumentacionin që përputhet me kriteret financiare: shtojcën 1, “Formularin e Çmimit të Ofertës” si dhe dokumentat e tjera që lidhen me ofertën financiare për projektin. Mbi këtë zarf duhet të shkruhet “**Oferta Financiare**”.
- Të dyja këto zarfe së bashku duhet të përfshihen në një zarf të vetëm.

Në anën e jashtme të zarfit të dorëzimit të dokumentacionit duhet të jetë informacioni në vijim:

- Emri dhe adresa e plotë e kompanisë, si dhe

- Shënimi "Ky zarf duhet të qëndrojë i mbyllur deri në seancën e hapjes"
- Oferta duhet dorëzuar në adresën e CHWB Albania: Rr. Ismail Qemali, P.34/1 Kt. V, Zyra Nr.22, Tiranë, Shqipëri.
- **Mënyra e dorëzimit:** Në një zarf të mbyllur dhe të vulosur, si në vijim: me postë rekomandë, me postë private të shpejtë, ose e dorëzuar në dorë. Çdo ofertë e dorëzuar do të shoqërohet me një procesverbal që vërteton dorëzimin e ofertës.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertës: Afati i fundit për dorëzimin e ofertës: Ora 11.00, ditën e hënë, 06 MAJ 2024.

Ato oferta që do të dorëzohen në mënyra dhe forma të tjera (p.sh. me faks ose me postë elektronike, etj.) nga ato që janë përmendur më lart, do të skualifikohen automatikisht dhe nuk do të merren parasysh lidhur me këtë tender.

IV. Hapja e ofertave - të dorëzuara

Ofertat e dorëzuara do të hapen në praninë e një përfaqësuesi nga secila kompani që ka dorëzuar një ofertë. Hapja e ofertave do të mbahet menjëherë pas afatit të fundit të dorëzimit të ofertave: **Ora 11:15, ditën e hënë, 6 MAJ 2024.**

Në të njëjtën kohë do të mbahet edhe procesverbali i pranimit të ofertës i cili do të firmoset nga punonjësit e CHWB Albania, nga një përfaqësues i IKTK, si dhe nga përfaqësuesit e të gjitha kompanive në garë, të cilët mund të marrin edhe një kopje të këtij procesverbali.

V. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- | | |
|--|---------|
| - Dorëzimi në kohë i aplikimit të plotë (ofertës financiare), bashkë me gjithë dokumentacionin shoqërues; | 5 pikë |
| - Cilësia e punimeve të mëparshme të kryera gjatë 5 viteve të fundit – të cilat janë paraqitur në aplikim; | 25 pikë |
| - Numri i viteve të punës në fushën e punimeve të restaurimit; | 15 pikë |
| - Niveli i ekspertizës në fushën e punimeve të restaurimit; | 25 pikë |
| - Aftësitë e mjeshtrave artizanë që do të angazhohen në punimet e restaurimit; | 25 pikë |
| - Policat (kontratat) e sigurimeve që mbulojnë punëtorët dhe palët e treta; | 5 pikë |
| - Përparësi do të kenë kompanitë që punojnë në zonën e Gjirokastrës dhe punësojnë banorë vendas. | |

Oferta më e ulët financiare nuk do të jetë kriter përzgjedhës përcaktues për fituesin.

VI. Lajmërimi për fituesin e tenderit

Kompania fituese do të njoftohet me telefon si dhe me një komunikim zyrtar me shkrim brenda një jave pas hapjes së ofertave financiare/aplikimeve, ndërkohë që të gjithë kompanitë e tjera do të njoftohen me një komunikim elektronik (e-mail).

VII. Sigurimi i Kontratës dhe Sigurimi i Punimeve

Pas shpalljes së fituesit, Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 20% e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, që është i bashkangjitur si Shtojca 3, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

Kompania fituese duhet që të dorëzojë *policat (kontratat)* e sigurimeve që dëshmojnë për mbulimin e detyrimeve financiare në lidhje me:

- Dëmet e mundshme materiale, në një vlerë prej 30.000.000,00 ALL;
- Përgjegjësi ndaj paleve te treta, në një vlerë prej 30.000.000,00 ALL;

Ky Sigurim duhet të jete i vlefshëm për nje periudhë **1 vjeçare**.

Shtojca 1

FORMULARI I ÇMIMIT TË OFERTËS

Emri i Ofertuesit _____

1	2	3	4	5	6
Nr.	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
Çmimi Neto					
TVSH (%)					
Çmimi Total Lek					
Çmimi Total Dollarë					
Çmimi Total Euro					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shtojca 2

[Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]
FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: *CHwB Albania*

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e prokurimit: *Private*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti i tenderit]

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej ----- leke si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga ofertuesi i lartpërmendur.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *CHwB Albania* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nese eshte percaktuar keshtu ne dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon nje gje te tille;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta eshte shpallur fituese ose nuk ka plotesuar ndonje kusht tjeter perpara nenshkrimit te kontrates se percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për një periudhë prej -----ditësh.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 3

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

Data _____

Për: *CHwB Albania*

Ne Emer te: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e prokurimit: *private*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [lloji i procedurës dhe objekti]

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve] në një shumë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [emri i autoritetit kontraktor]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda ----- (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]